



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**VENDIM**

Nr.171 , Datë 17/01/2011

**Për**

**një ndryshim në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Rezana KONOMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2011, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shtyrja e afatit në lidhje me hetimin paraprakë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit.

**Baza ligjore:** - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);  
- Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Pasi mori në shqyrtim informacionin dhe kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm për një shtyrje afati në lidhje me hetimin paraprakë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit,

**VËREN SE:**

1. Me anë të Vendimit Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

